




REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.4;22x.9-2014/2016-08

Menaxhimi i procesit të pajisjes së nxënësve me tekste shkollore



Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm, i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikrat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse programet qeveritare menaxhohen në mënyrë të duhur, kost-efektive dhe efikase dhe nëse sistemet për matjen dhe raportimin e efikasitetit tyre janë funksionale.

Ky raport vlerëson nëse menaxhimi i procesit të pajisjes së nxënësve me tekste shkollore është duke u kryer në mënyrë ekonomike dhe efikase.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me këtë raport të auditimit “Menaxhimi i procesit të pajisjes së nxënësve me tekste shkollore” në konsultim me Zëvendës Auditorin e Përgjithshëm Artan Venhari, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti i lëshuar është rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të auditimit Mirlinda Ahmeti, i mbështetur nga Fexhrie Thaqi (Udhëheqëse e ekipit) dhe Drilon Shala (Anëtar ekipi) .

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhja ekzekutive.....	i
1 Hyrje	1
1.1 Indikatorët e problemit të auditimit.....	2
1.2 Objektiva dhe pyetjet e auditimit.....	4
1.3 Kriteret e auditimit.....	4
1.4 Fushëveprimi i auditimit.....	5
1.5 Metodologjia e auditimit.....	5
2 Korniza ligjore dhe palët e përgjegjëse në proces	7
2.1 Udhëzimi Administrativ për rregullimin e procesit të pajisjes së nxënësve me tekste shkollore.....	7
2.2 Përgjegjësitë e MASHT.....	7
2.3 Përgjegjësitë e DKA.....	8
2.4 Përgjegjësitë e shkollave.....	8
3 Të gjeturat e auditimit.....	10
3.1 Çështjet e identifikuar në Udhëzim Administrativ	10
3.2 Planifikimi i pajisjes së nxënësve me tekste shkollore	10
3.3 Shpërndarja e teksteve dhe monitorimi.....	12
3.4 Stoqet e identifikuar në komuna.....	13
3.5 Kthimi dhe ripërdorimi i teksteve shkollore	14
3.6 Riciklimi i teksteve shkollore.....	16
4 Konkluzione.....	17
5 Rekomandime	19
Shtojca 1. Kontrata me prindërit, shkolla fillore “Vaso Pashë Shkodrani”	20
Shtojca 2. Marrëveshja me prindërit, shkolla fillore “Izvor”	21
Shtojca 3. Shpërndarja e teksteve për nxënësit e shkollës fillore “Selman Riza”	22

Lista e shkurtesave

MAShT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
UA	Udhëzimi Administrativ
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit

Përmbledhja ekzekutive

Çka kemi audituar?

Që nga viti 2008 Qeveria e Kosovës financon pajisjen me tekste shkollore për rreth 275 mijë nxënës nga klasa parë deri në klasën e nëntë.

Përmes këtij auditimi ne kemi vlerësuar nëse akterët përgjegjës sigurojnë proces efikas gjatë planifikimit, shpërndarjes, kthimit, ripërdorimit dhe riciklimit të teksteve shkollore. Po ashtu, përmes rekomandimeve tona kemi për qëllim të sigurojmë shfrytëzim optimal të teksteve shkollore për një periudhë prej minimum dy vitesh dhe kësaj të reduktohen edhe shpenzimet e mëdha që bëhen për këtë qëllim.

Entitetet e audituara janë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, tri komuna që mbulojnë 167 shkolla fillore ose rreth 62,500 nxënës. Komunitat e përzgjedhura janë Prizreni, Peja dhe Gjakova në kuadër të të cilave kemi përzgjedhur nëntë shkolla.

Auditimi përfshin vitet shkollore 2013/14, 2014/15 dhe 2015/16.

Çka kemi gjetur?

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, komunitat dhe shkollat nuk kanë menaxhuar mirë procesin dhe lidhur me këtë të gjeturat e auditimit janë:

- Udhëzimi Administrativ 16/2012 për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore ka shkaktuar konfuzion kur bëhet fjalë për termet e përdorura se tekstet shkollore jepen falas dhe duke kërkuar që tekstet shkollore të kthehen për ripërdorim për më së paku deri në dy vite;
- Edhe pse udhëzimi administrativ përcakton hapat që duhet të ndiqen nga zyrtarët përgjegjës, atij i mungon përcaktimi i formularëve që do të përdoren nga komunitat, drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit, për të siguruar se tekstet e dhëna në fillim të vitit kthehen në fund të vitit shkollor;
- Disa komuna dhe shkolla nuk janë të informuara rreth ekzistencës së udhëzimit administrativ, i cili është bazë për këtë proces. Si pasojë e kësaj kemi mënyra të ndryshme të kërkesave për tekste shkollore;
- Ka mangësi në planifikim duke qenë se komisionet emërohen me vonesë. Komisioni për negociimin e çmimit për tekste shkollore emërohet në qershor dhe korrik. Ndërsa komisioni për shpërndarjen e tyre pas 5 gushtit përderisa me 1 shtator të gjithë nxënësit duhet të jenë të pajisur me tekste shkollore. Për shkak të kohës së kufizuar, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk ka arritur të analizojë kërkesat për tekste të reja shkollore dhe atyre të kthyera në raport me numrin e nxënësve;
- Edhe pse Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka ndërmarr aktivitete për të numëruar stoqet dhe është angazhuar në integrimin e tyre në kërkesat për tekste të reja, gjatë auditimit ne kemi vërejtur që komunitat dhe shkollat vazhdojnë të kenë numër të konsiderueshëm stoqesh;

- Në komuna dhe shkolla nuk janë emëruar komisionet përgjegjëse për shpërndarjen e teksteve shkollore tek mësimdhënësit dhe më pas tek nxënësit dhe si pasojë nuk ka analizë për numrin e teksteve të pranuar në fillim dhe atyre të kthyer në fund të vitit shkollor;
- Kthimi i teksteve shkollore vazhdon të jetë në nivel të ulët, duke rezultuar në shpenzime të larta për porosinë e teksteve shkollore; dhe
- Riciklimi i librave shkollor edhe pse është praktikuar në një numër të vogël shkollave mbetet një aspekt për tu adresuar seriozisht.

Çka rekomandojmë?

Për të siguruar përdorim efikas të teksteve shkollore, më poshtë paraqesim rekomandimet tona për akterët përgjegjës me qëllim të zvogëlimit të shpenzimeve dhe përmirësimin e planifikimit, shpërndarjes, kthimit dhe ripërdorimit të teksteve.

Rekomandojmë Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë që të:

- Rishikojë Udhëzimin Administrativ 16/2012 për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore, posaçërisht në modifikimin e termit “falas” me “huazim” dhe të integrojë riciklimin e teksteve brenda këtij udhëzimi;
- Të krijojë formularë për menaxhim më të mirë të planifikimit, shpërndarjes, kthimit dhe riciklimit të teksteve dhe të sigurojë që ato janë duke u praktikuar plotësisht nga shkollat;
- Përmirësojë komunikimin me drejtorët e Drejtorive Komunale të Arsimit në mënyrë që ata t’ia transmetojnë informacionin drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve lidhur me ekzistimin e Udhëzimit Administrativ dhe monitorojë implementimin e tij;
- Themelojë në kohë të përshtatshme komisionet për pajisje dhe shpërndarje në mënyrë që të ketë kohë të mjaftueshme për të analizuar të dhënat e siguruar nga shkollat dhe për të bërë planifikim real të nevojave për tekste shkollore duke përfshirë edhe tekstet e kthyer.

Rekomandojmë Drejtorët e Drejtorive Komunale të Arsimit dhe drejtorët e shkollave të:

- Sigurojnë se shkollat kanë integruar në kërkesat e tyre tekstet e kthyer dhe se asnjë kërkesë nuk do të procedohet në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë para se kjo të kryhet nga shkolla;
- Ndërmerr masat e duhura për shmangien e plotë të mundësisë për krijimin e stoqeve me tekste shkollore në depot e komunave dhe nëpër shkolla;
- Krijojnë komisionet për pranimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore dhe përfshijnë mësimdhënësit në shpërndarjen e teksteve shkollore;
- Komunikojnë në mënyrë aktive me mësimdhënësit për të siguruar që nxënësit t’i kthejnë tekstet shkollore dhe të kujdesen për to në mënyrë që ato të ripërdoren.

1 Hyrje

Në Kosovë janë rreth 275 mijë nxënës, të cilët pranojnë tekste shkollore falas çdo vit nga Qeveria për çka shpenzohen shuma të konsiderueshme financiare. Kjo është një mbështetje e madhe për qytetarët e Kosovës, duke pasur parasysh se rreth 30% e popullsisë jeton në varfëri të skajshme, 35% janë të papunë dhe pjesa tjetër e popullsisë, të cilët janë të punësuar, kanë një rrogë mesatare mujore prej 346 euro.

Në vende të rajonit¹ dhe Evropë² është praktikuar pajisja e nxënësve me tekste shkollore falas. Një shembull i mirë në këtë aspekt aplikohet në Irlandë, e cila ka zhvilluar udhëzime për huazimin³ e teksteve shkollore nxënësve. Udhëzimet paraqesin parime të praktikës së mirë të bazuara në përvojën e shkollave dhe shoqatave të prindërve, të cilët aplikojnë skema të suksesshme për huazimin e teksteve shkollore.

Në mënyrë që të ketë ndarje të duhur të përgjegjësive Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka nxjerrë një Udhëzim Administrativ (UA)⁴. Sipas këtij udhëzimi, MASHT organizon pajisjen me tekstet shkollore, ndërsa, në bashkëpunim me komunat dhe shkollat, ai organizon shpërndarjen dhe siguron që tekstet shkollore të kthehen në fund të çdo viti shkollor dhe të përdoren minimum dy vite.

Vendimi për financimin e teksteve shkollore për nxënësit e shkollave publike është marrë në vitin 2008 dhe mbulon të gjitha lëndët e përfshira në kurikulat⁵ e shkollave fillore. Meqenëse shkolla fillore është e detyrueshme, qeveria i mbulon të gjitha shpenzimet për tekstet shkollore që nga klasa e parë deri tek e nënta.

Gjithashtu, përdorimi i librave shkollor për më shumë se dy vjet është i rëndësishëm nëse shikohet edhe nga aspekti mjedisor. Sipas një studimi⁶ të kryer, shtypja e librave në nivel botëror konsumon më shumë se 100 milion drunj për çdo vit.

¹ Maqedonia, ndërsa Shqipëria i ndihmon nxënësit me ndihmë sociale.

² Suedia, Irlanda.

³ Udhëzues për hartimin e teksteve shkollore, skemat e huazimit në shkolla, Departamenti i Arsimit dhe Aftësive, Irlandë

⁴ UA 16/2012 për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore falas, përdorimi dhe ruajtja e tyre


⁵ Ligji për Arsimin para universitar, Kapitulli 5, paragrafi 13 dhe UA nr.16/2012 për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore, përdorimi dhe ruajtja e tyre.

⁶ Hutsko, J. (Gusht, 2009), Are Green Readers Greener than Books, New York Times

1.1 Indikatorët e problemit të auditimit

Buxheti vjetor i planifikuar për mbulimin e shpenzimeve të teksteve të blera nga klasat e para e deri tek e nënta ndryshon shumë nga ai i ekzekutuar edhe pse teorikisht për këtë arsye shpenzimet do të duhej të kishin rënë, duke pasur parasysh që, sipas UA, tekstet shkollore duhet të përdoren minimum dy vite.


Grafiku 1. Dallimet midis buxhetit të planifikuar dhe të shpenzuar për tekste shkollore



Burimi: Free balance, Ministra e Financave

Grafiku i mësipërm tregon për mospërputhjet në mes të buxhetit të planifikuar dhe atij të ekzekutuar për furnizimin me tekste shkollore dhe kjo dukuri është e evidente në të tre vitet. Gjithsesi, sipas të dhënave të buxhetit të ekzekutuar vërejmë që në vitin 2014/15 janë shpenzuar 11% më pak mjete financiare se në vitin 2013/14. Ndërkaq, në vitin 2015/16 shpenzimet kanë shënuar 3% ngritje krahasuar me vitin 2014/15. Përveç kësaj, vërehet se mesatarja e shpenzimeve për këto tre vite vazhdon të jetë e lartë, respektivisht qëndron në 7.5 milion euro. Duke iu referuar Grafikut 2 vërejmë se shpenzimet nuk kanë pësuar rënie përkundër zvogëlimit të numrit të nxënësve.

Grafiku 2. Numri i nxënësve në shkolla fillore



Burimi: Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë⁷

⁷ Për vitet akademike 2013/14 dhe 2014/15 të dhënat janë marrë nga dokumenti Statistikat e Arsimit në Kosovë, maj 2014/15, MASHT. Për vitin 2015/2016 të dhënat janë marrë nga dokumenti "Të dhëna në Edukimin Para-universitar, Shënime Statistike", 2015/16, MASHT.

ZAP ka kryer gjithashtu auditime të rregullsisë mbi procesin e shpërndarjes së teksteve shkollore tek nxënësit. Duke u bazuar në të dhënat e tyre, ekzistojnë probleme në planifikim, shpërndarje dhe kthim të teksteve shkollore. Është gjetur se tekste të reja shkollore në vlerë prej mbi gjysmë milion eurove mbeten të papërdorura në disa shkolla, ndërsa disa të tjera nuk e kanë marrë numrin e duhur të teksteve. Ky është një tregues që nxjerr në pah probleme që ndërlidhen me planifikimin, shpërndarjen dhe kthimin e teksteve shkollore.

Përveç faktit se një sasi e madhe e parave të taksapaguesve shpenzohet për këtë qëllim në mënyrë joadekuate, një indikator tjetër që tregon se kjo çështje mbetet problem është mungesa e vetëdijesimit të nxënësve për shfrytëzim optimal të këtyre teksteve.

1.2 Objektiva dhe pyetjet e auditimit

Objektivë e këtij auditimi është që të vlerësohet nëse planifikimi, shpërndarja dhe kthimi i teksteve shkollore është duke u menaxhuar në mënyrë efikase nga entitetet përgjegjëse dhe nëse tekstet e shpërndara janë duke u përdorur nga nxënësit në mënyrë optimale. Qëllimi është që palëve përgjegjëse në proces t'u jepen rekomandime relevante dhe me veprime të duhura të reduktojnë buxhetin e shpenzuar për tekste shkollore duke i përdorur ato për më shumë se një vit.

Në mënyrë që t'i përgjigjemi objektivës së këtij auditimi kemi formuluar pyetjet vijuese të auditimit.

Pyetja kryesore e auditimit është:

A sigurojnë entitetet përgjegjëse se tekstet shkollore planifikohen, shpërndahen, kthehen dhe ripërdoren në mënyrë efikase?

Ndërsa nën pyetjet që do përdoren për t'iu përgjigjur pyetjes kryesore të auditimit janë:

- 1. A është duke e organizuar MASHT procesin e pajisjes me teksteve shkollore në mënyrë efikase dhe me kohë?*
- 2. A janë duke u siguruar komunat se i posedojnë informatat e sakta në mënyrë që të shpërndajnë tekstet sipas nevojave të shkollave?*
- 3. A janë duke u siguruar shkollat që komunat pranojnë informatat e duhura në lidhje me numrin e duhur e teksteve të nevojshme dhe se tekstet janë duke u kthyer dhe ripërdorur?*

1.3 Kriteret e auditimit

Në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikat e mira të përdorura brenda dhe jashtë vendit, ne kemi vendosur kriteret e mëposhtme, të cilat do të sigurojnë një proces të duhur të shpërndarjes së teksteve shkollore, nëse:

- Procesi i shpërndarjes së teksteve shkollore planifikohet si duhet për të siguruar se nxënësit pajisen me sasinë e nevojshme të teksteve dhe në kohë;⁸
- Ministria përgjegjëse ka bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm me zyrtarët komunal në mënyrë që t'i informojnë ata rreth procesit të shpërndarjes, mënyrës se si është i rregulluar dhe cilat janë përgjegjësitë e tyre në raport me këtë proces;
- Komunat kanë komunikim të qartë dhe të vazhdueshëm me drejtorët e shkollave dhe stafin e tyre lidhur me të dhënat që duhet të përfshihen në kërkesat për tekste shkollore;
- Drejtorët e shkollave sigurojnë që tekstet shkollore të kthehen dhe të përfshihen në kërkesat që i paraqiten Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA);

⁸ UA 16/2012 për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore falas, përdorimi dhe ruajtja e tyre, paragrafi 3

- DKA kryejnë monitorime për të verifikuar kërkesat e paraqitura nga shkollat;⁹ dhe
- Tekstet shkollore që mbesin në depo të ndryshme, qofshin nëpër shkolla apo hapësira tjera që konsiderohen se janë të papërdorshme riciklohen në mënyrën e duhur.¹⁰

1.4 Fushëveprimi i auditimit

Në këtë auditim jemi fokusuar në planifikimin, shpërndarjen, kthimin, ripërdorimin dhe riciklimin e teksteve shkollore tek nxënësit dhe në aktivitetet e kryera nga MASHT, DKA dhe shkollat përkatëse për të siguruar përdorim optimal të teksteve shkollore.

Entitetet e audituara janë MASHT, tri Komuna që mbulojnë 167 shkolla fillore me rreth 62,500 nxënës. Komunitet e përzgjedhura janë Prizreni, Peja dhe Gjakova. Në këto komuna kemi përzgjedhur nëntë shkolla.

Auditimi përfshin vitet shkollore 2013/14, 2014/15 dhe 2015/16.

1.5 Metodologjia e auditimit

Ne kemi përdorur një numër metodash në mënyrë që ti japim përgjigje pyetjeve të auditimit. Gjatë kryerjes së auditimit ne kemi:

- Analizuar kornizën ligjore në aspektin e të drejtave dhe detyrimeve lidhur me tekstet shkollore të shpërndara nga MASHT;
- Analizuar praktikën e mira për të kuptuar procesin e shpërndarjes së teksteve shkollore;
- Analizuar kërkesat për tekste shkollore;
- Intervistuar shtatë zyrtarë të MASHT ndër të cilët: Sekretarin e Përgjithshëm, Udhëheqësin dhe anëtarët e Komisionit për shpërndarjen e teksteve shkollore, anëtarët e Komisionit për verifikimin e stokut, zyrtarë nga Departamenti i statistikave;
- Intervistuar tre drejtorë të DKA, një zyrtar brenda secilit DKA të përfshirë drejtpërsëdrejti në procesin e shpërndarjes së teksteve shkollore;
- Intervistuar drejtorët e nëntë shkollave, 18 mësimdhënës dhe sekretarët e tre shkollave për të kuptuar se si kryhet procesi i shpërndarjes dhe kthimit të teksteve shkollore;
- Analizuar vendimet e marra nga MASHT lidhur me shpërndarjen e teksteve shkollore;
- Vëzhguar dhe analizuar aktivitete të tjera për adresimin e shpërndarjes së teksteve shkollore, si:
 - Korrespondencën përmes postës elektronike mes MASHT dhe komunave;

⁹ Ibid, Kapitulli 5 dhe vendimi i nxjerrë çdo vit nga Sekretari Përgjithshëm në MASHT.

¹⁰ Hickey, S. L. dhe Jones M. K. (Nëntor 2012), Hulumtim për riciklim të teksteve shkollore – Rekomandimet për përdorimin e duhur dhe ridestinimin e teksteve shkollore në përfundimin e ciklit të tyre të përdorimit, Mc Graw Hill

- Korrespondencën përmes postës elektronike mes zyrtarëve të DKA dhe drejtorëve të shkollave, ku u janë komunikuar udhëzuesit për hartimin e kërkesave (të cilët përfshijnë edhe deklaratën rreth teksteve shkollore që duhet dhe nuk duhet të kthehen si dhe formularët e shpërndarjes);
- Vëzhguar formularët e regjistruar të komisioneve të ngarkuara me pranimin e teksteve;
- Formularët dhe regjistrat e përdorur nga mësimdhënësit për shpërndarjen e teksteve shkollore tek nxënësit dhe ato për tekstet e kthyera; dhe
- Kontratat e nënshkruara nga shkollat dhe prindërit, si një formë obligimi që tekstet shkollore të përdoren si duhet dhe të kthehen për ripërdorim.

2 Korniza ligjore dhe palët e përgjegjëse në proces

Ky kapitull përshkruan organizimin e procesit të pajisjes me tekste shkollore përmes UA, mënyrën e përfshirjes së akterëve kyç në proces si dhe përgjegjësitë e tyre.

2.1 Udhëzimi Administrativ për rregullimin e procesit të pajisjes së nxënësve me tekste shkollore

MAShT ka marrë për obligim që të bëjë pajisjen e nxënësve me tekste shkollore dhe këtë e ka rregulluar përmes UA 16/2012 sipas të cilit përcaktohet mënyra e shpërndarjes së këtyre teksteve tek nxënësit e shkollave fillore, klasat 1deri 9.

UA¹¹ përshkruan rolin e MAShT, DKA dhe shkollave si dhe përcakton bazën për funksionimin aktual të procesit që përfshin planifikimin, shpërndarjen, kthimin dhe ripërdorimin e teksteve shkollore.

Brenda procesit, UA i lëshuar nga MAShT, ndan detyrat në tre nivele. Lidhur me këtë MAShT është përgjegjëse për organizimin e pajisjes dhe shpërndarjes së teksteve shkollore tek DKA e cila së bashku me shkollat koordinon numrin e teksteve shkollore që kërkohen për çdo vit shkollor. DKA është gjithashtu përgjegjëse për organizimin e shpërndarjes së teksteve shkollore tek çdo shkollë.¹²

Sipas këtij udhëzimi, nxënësit e kanë për obligim që në fund të çdo viti shkollor t'i dorëzojnë/kthejnë në shkollë tekstet në gjendje të rregullt ose në rastin e dëmtimit të teksteve me qëllim apo nga pakujdesia, nxënësi përkatësisht prindi obligohet të kompensojë atë duke e zëvendësuar me tekst të ri.

2.2 Përgjegjësitë e MAShT

Siç u përmend më lart, MAShT merret me pajisjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore. MAShT ka caktuar komisione të ndryshme për t'ua deleguar përgjegjësitë e veta dhe për ta bërë procesin e pajisjes dhe shpërndarjes së teksteve shkollore funksional.¹³

Në këtë drejtim, pajisja me tekste është organizuar nga komisioni i pajisjes i përbërë nga zyrtarë të MAShT i ngarkuar për të negociuar çmimin me kompanitë botuese.

Komisioni i shpërndarjes¹⁴ është komisioni tjetër i caktuar nga MAShT. Ky komision pranon të dhëna nga zyrtarët e DKA në mënyrë që të ketë informacionin e nevojshëm lidhur me numrin e teksteve që duhet të shpërndahen për çdo shkollë. Komisioni i shpërndarjes është gjithashtu

¹¹ UA 16/2012 për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore falas, përdorimi dhe ruajtja e tyre

¹² Ibid, Kapitujt 2,3 dhe 4

¹³ Vendimi i nxjerrë çdo vit shkollor nga Sekretari Përgjithshëm

¹⁴ Ibid.

përgjegjës për vlerësimin e të dhënave që japin DKA në mënyrë që të sigurojë se shkollat kanë implementuar kthimin e teksteve dhe se ka një ulje të kërkesave nga ana e tyre. Ky komision ka të drejtë të kthejë kërkesat tek DKA në rast se konsiderohet se është e nevojshme të bëhen ndryshime. Së fundmi, komisioni është gjithashtu përgjegjës që të dërgojë kërkesat përfundimtare tek kompanitë botuese në mënyrë që ata të informohen për numrin e saktë të teksteve shkollore që duhet të shpërndahen.

MAShT është pjesërisht përgjegjës për të monitoruar shpërndarjen e teksteve shkollore, si rrjedhim ajo cakton një tjetër komision për këtë.¹⁵ Ky komision përbëhet nga zyrtarë të ndryshëm brenda MAShT dhe nga inspektorët rajonal për arsim.

2.3 Përgjegjësitë e DKA

Drejtorët e DKA janë përgjegjës për koordinimin, shpërndarjen dhe monitorimin e teksteve shkollore nga klasa e parë tek e nënta. Ata pranojnë raporte nga drejtorët e shkollave lidhur me shpërndarjen e teksteve shkollore.¹⁶

DKA është përgjegjëse që të informojnë drejtorët e shkollave rreth kërkesave që ata duhet të paraqesin për sa i përket numrit të teksteve shkollore që atyre u nevojiten për vitin e ardhshëm shkollor. Pas dorëzimit të kërkesave nga drejtorët e shkollave, DKA i vlerëson këto kërkesa për të parë nëse shkollat i kanë zbatuar kërkesat e UA (veçanërisht nëse i kanë integruar tekstet e kthyer shkollore në kërkesat e tyre). Pas vlerësimit të kërkesave, DKA kanë përgjegjësi ti dërgojnë ato tek Komisioni i shpërndarjes në MAShT.

Roli i DKA është që të monitorojë nëse secila shkollë e ka komisionin e brendshëm, përgjegjësia e të cilit është të pranojë tekstet shkollore të shpërndara nga kompanitë botuese.

2.4 Përgjegjësitë e shkollave

Drejtorët, zëvendës drejtorët, dhe sekretarët e shkollave janë autorizuar nga DKA, përmes një vendimi¹⁷ të nënshkruar nga MAShT, për të pranuar dhe shpërndarë tekstet shkollore dhe për të nënshkruar formularët e teksteve shkollore të ofruar nga kompanitë botuese.

Fillimisht, është përgjegjësi e secilit mësimdhënës të kërkojë nga nxënësit e tij/saj që të kujdesen për tekstet që ata i marrin dhe t'i kthejnë ato në gjendje të mirë pas mbarimit të vitit shkollor. Mbajnë gjithashtu përgjegjësi që të dokumentojnë çdo libër të pranuar nga secili nxënës në fillim të vitit shkollor, por edhe të dokumentojnë tekstet e kthyer nga po të njëjtët nxënës.¹⁸ Gjatë llogaritjes së numrit të kërkuar të teksteve për klasë, mësimdhënësit duhet të sigurojnë që edhe ato të kthyerat të përfshihen në këtë llogaritje.

¹⁵ Vendimi i lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm në MAShT, korrik 2015.

¹⁶ UA 16/2012 për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore falas, përdorimi dhe ruajtja e tyre, paragrafët 4 dhe 5, dhe vendimet e nxjerra nga Sekretari i Përgjithshëm i MASHT më 05.08.2013 dhe 18.08.2014.


¹⁷ Vendimi i lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MASHT më 05.08.2013 dhe 18.08.2014.

¹⁸ UA 16/2012 për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore falas, përdorimi dhe ruajtja e tyre, paragrafët 7 dhe 8

Mësimdhënësit janë po ashtu përgjegjës për vlerësimin e gjendjes së teksteve të kthyera në mënyrë që të klasifikojë ato që mund të përdoren për vitin tjetër shkollor. Për t'i zbatuar të gjitha këto përgjegjësi, drejtori i shkollës duhet t'i informojë mësimdhënësit për këto procedura. Ndërkohë, drejtori i shkollës është përgjegjës për monitorimin e kërkesave të hartuara nga mësimdhënësit dhe të analizojë nëse numri i teksteve shkollore është duke u zvogëluar nga viti në vit.

Afatet kohore për kryerjen e aktiviteteve nga palët e përfshira në proces i kemi paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 3. Afatet kohore për kryerjen e aktiviteteve



3 Të gjeturat e auditimit

Ky kapitull përfshin të gjeturat e auditimit që ndërlidhet me planifikimin, shpërndarjen, kthimin, ripërdorimin dhe riciklimin e teksteve shkollore.

3.1 Çështjet e identifikuara në Udhëzim Administrativ

UA, sipas së cilit është dashur të sigurohet mbarëvajtja e procesit në fjalë, ka mangësi në terminologjinë e tij dhe mungesë të formularëve për zbatimin e tij. Tek disa nga palët e përfshira në proces mungon edhe informacioni rreth ekzistimit të tij.

Sipas këtij UA, tekstet shkollore jepen falas duke theksuar në të njëjtën kohë se tekstet shkollore duhet të kthehen për ripërdorim. Bazuar në intervistat e kryera, kjo ka krijuar huti në mesin e mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve nëse tekstet duhet të kthehen apo jo. Lidhur me këtë, DKA dhe shumica e shkollave të audituara konfirmojnë se nxënësit hezitojnë t'i kthejnë tekstet dhe në shumicën e rasteve refuzojnë ti marrin tekstet e përdorura, të cilat në bazë të UA duhet të përdoren më së paku dy vite.

Gjatë intervistave me zyrtarëve të DKA, drejtorëve të shkollave, dhe mësimdhënësve, ne kemi vërejtur se shumë pak prej tyre janë të informuar rreth ekzistencës së këtij UA, edhe pse ai është i qashtëm në web faqen zyrtare të MASHT.

Edhe pse UA përcakton hapat që duhet të ndiqen nga zyrtarët përgjegjës, atij i mungon përcaktimi i formularëve që do të përdoren nga komunitat, drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit, për të siguruar se tekstet e dhëna në fillim të vitit kthehen në fund të vitit shkollor.

3.2 Planifikimi i pajisjes së nxënësve me tekste shkollore

Faza e planifikimit është thelbësore dhe shumë e ndërlidhur me kthimin e teksteve e cila duhet të kryhet deri në fund të secilit vit shkollor. Kjo fazë konsiston në analizimin e kërkesave për tekste shkollore nga shkollat tek DKA dhe të kërkesave të bëra nga DKA tek komisioni i shpërndarjes në MASHT.

MASHT, gjatë muajve qershor dhe korrik¹⁹, emëron komisionin për pajisjen me tekste shkollore për të negociuar çmimin e teksteve me kompanitë botuese. Ndërkohë, emërimi i komisionit për shpërndarjen e teksteve shkollore bëhet pas 5 gushtit²⁰. Sipas të dhënave të mbledhura dhe intervistave²¹ të kryera në teren, shkollat i kanë dërguar kërkesat për tekste shkollore tek DKA gjatë muajit qershor. Përveç kësaj, kërkesat mbesin në ambientet e DKA dhe nuk dorëzohen

¹⁹ Për periudhën e audituar emërimet e komisioneve për negocimin e çmimeve janë: 19.03.2013 01.07.2014; për vitin 2015 nuk ka të dhëna.

²⁰ Për periudhën e audituar vendimi për emërimin e komisionit për shpërndarjen e teksteve shkollore është marrë më 14.08.2013; 06.08.2014 dhe 07.07.2015 dhe më vonë është ndryshuar më 05.08.2015.

²¹ Intervista me drejtorin e DKA dhe drejtorët e shkollave, tetor-dhjetor 2015. Listat e kërkesave për tekste shkollore dërgohen në fund të qershorit.

përveç nëse kërkohen nga MASHT. Kjo kërkesë nga MASHT përcillet tek DKA në mes të gushtit. Për shkak të kësaj, planifikimi kryhet brenda një afati kohor shumë të kufizuar, duke rezultuar kështu në mungesë të kontrollit mbi të. Nevojat për tekste shkollore duhet të mblidhen brenda 15 ditëve²² dhe të shpërndahen ato nëpër të gjitha komunat dhe shkollat. Për shkak të kohës së shkurtër, MASHT asnjëherë nuk ka bërë vlerësim të kërkesave të dërguara DKA. Mungesa e këtij vlerësimi dhe numri i vogël i teksteve të kthyer ka rezultuar në një numër më të madh të kërkesave për tekste të reja shkollore.

Përveç kësaj, një tjetër mangësi lidhur me shkollat është se kërkesat e bëra për tekste shkollore nga disa prej tyre nuk e kanë vlerësimin rreth gjendjes së teksteve të kthyer. Kjo mund të ndikojë negativisht në planifikim. Vetëm stafi i pesë nga nëntë shkollat e audituara²³ kanë bërë vlerësimin e gjendjes së teksteve të kthyer nga nxënësit dhe kanë hartuar kërkesat për tekstet shtesë, siç u është kërkuar nga drejtori i shkollës.

Analiza e kërkesave për tekste shkollore e përpiluar nga shkollat

Komisioni për shpërndarje të teksteve shkollore është caktuar për të mbledhur informata nga DKA në lidhje me numrin e teksteve të kërkuara për të gjithë nxënësit. Për shkak të emërimit²⁴ me vonesë të komisionit nuk ka kohë në dispozicion as për të analizuar e as për të krahasuar kërkesat e secilës kompani për tekste shkollore. Kështu që nuk ka ndonjë dëshmi për analiza të kryera mbi normën e kthimit të teksteve shkollore, e cila drejtpërsëdrejti ndërlidhet me kërkesat për tekste shkollore.

Duke u bazuar në të gjeturat e auditimit të prezantuara nga auditorët e rregullsisë në ZAP, një numër i madh i teksteve të përdorura mbeten në shkolla si stoqe. MASHT ka vlerësuar dhe llogaritur numrin e saktë të teksteve dhe është përpjekur që të sigurojë se DKA do zvogëlojnë numrin e kërkesave për tekste shkollore. Megjithatë, bazuar në shumën e shpenzuar këtë vit për tekstet dhe për shkak të kohës së kufizuar për kërkesë dhe shpërndarje, MASHT nuk ka vlerësuar nëse stoqet janë përfshirë në kërkesat për tekste shkollore.

Për ta verifikuar normën e kërkesave totale, ne kemi kryer një analizë duke krahasuar shpenzimet dhe numrin e nxënësve. Tabela e mëposhtme paraqet shpenzimet mesatare për nxënësit gjatë tri viteve të shkollës të mbuluara nga auditimi ynë.

²² Vendimi për emërimin e komisionit për pajisje me tekste shkollore, pranimin e teksteve nga DKA dhe shkollat.

²³ "Hil Mosi", "Dëshmorët e Kombit", "Izvor" "Selman Riza" dhe "Dardania"

²⁴ Shih referencën 8.

Tabela 1. Shpenzimet mesatare për nxënës gjatë tre viteve shkollore

Viti shkollor	Numri i nxënësve në arsimin fillor (000)	Shuma e shpenzuar këtë vit për tekste shkollore (000€)	Shpenzimet mesatare për nxënës (€) ²⁵
2013/14	279	8,000	29
2014/15	276	7,200	26
2015/16	261	7,400	28

Bazuar në shifrat e paraqitura në tabelën e mësipërme²⁶, shuma e shpenzuar në 2014/15 dhe 2015/16 është ulur në krahasim me 2013/14, por njëkohësisht edhe numri i nxënësve ka rënë. Ndërkohë, në 2015/16 ka një rritje të shumës së shpenzuar për tekstet shkollore krahasuar me atë të 2014/15 edhe pse MASHT ka ndërmarr një aktivitet për të numëruar stoqet e teksteve shkollore në të gjitha shkollat (shih nën-kapitullin 3.4). Këto tekste në stoqe janë përfshirë në kërkesat që dërgohen për tekste të reja shkollore dhe shuma e tyre ka qenë mbi gjysmë milion euro. Për këtë nuk është dhënë asnjë arsyetim, duke pasur parasysh që nga viti në vit edhe numri i nxënësve është zvogëluar në masë të madhe. Një ndikim i madh do të ishte vënë re nëse kërkesat për tekste shkollore do të ishin analizuar siç duhet, d.m.th, nëse norma e teksteve shkollore të kthyera do të ishte e lartë dhe e integruar në këto kërkesa. Aspekti i kthimit të teksteve shkollore do të trajtohet më hollësisht në nën-kapitullin 3.5 të këtij raporti.

MASHT ka një kontratë me katër kompani për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore. Njëra nga kompanitë është përgjegjëse për pajisjen e teksteve të gjuhës angleze për klasën e nëntë. Çdo vit ka vonesa në pajisjen me këto tekste. Zakonisht, ato ju shpërndahen nxënësve gjatë muajit nëntor apo edhe dhjetor. Kërkesat e MASHT për tekstet e gjuhës angleze bëhen në mes të gushtit dhe si rezultat i kësaj tekstet nuk arrijnë tek nxënësit në fillim të vitit shkollor.

3.3 Shpërndarja e teksteve dhe monitorimi

Një nga përgjegjësitë e MASHT është shpërndarja e teksteve shkollore për secilën komunë përmes komisionit për shpërndarjen e teksteve shkollore. Emërimi i këtij komisioni është bërë me vonesë dhe kjo ka ndikuar në kohën e kufizuar për shpërndarjen e teksteve shkollore²⁷, vetëm pesë ditë, për të kryer këtë aktivitet. Si rezultat i kësaj DKA dhe shkollat nuk kanë arritur t'i zbatojnë kërkesat që dalin nga UA.

Për të mbikëqyrur mënyrën e shpërndarjes së teksteve shkollore MASHT ka emëruar komisionet monitoruese të përbërë nga tre deri në katër anëtarë dhe kanë të drejtën për të monitoruar dhe nënshkruar pranimin e teksteve nga çdo shkollë. Megjithatë, për shkak të kohës së kufizuar të

²⁵ Nëse nxënësit do të pajiseshin me të gjitha tekstet, mesatarja për nxënës do të ishte €30.

²⁶ Në këtë tabelë nuk janë përfshirë të dhënat për porositë që janë bërë edhe për nxënësit shqiptarë në diasporë dhe në Serbi, meqë për këtë nuk na janë ofruar të dhëna. Se librat janë porositur edhe për këta qytetar janë deklaruar zyrtarët në MASHT.

²⁷ Sipas dëshmimeve të ofruara nga MASHT, DKA dhe shkollat shpërndarja fillon pas 25 Gushtit

shpërndarjes, këto komisione nuk kanë mundur t'i monitorojnë të gjitha shkollat. Gjatë këtij auditimi jemi informuar se anëtarët e komisionit kanë mundur t'i vizitojnë vetëm pesë deri gjashtë shkolla gjatë shpërndarjes.²⁸

Kemi vërejtur se shpërndarja e teksteve shkollore nga komuna në shkollë organizohet në mënyra të ndryshme. Komuna e Prizrenit dhe Pejës kanë një vend ku tekstet shkollore ruhen dhe pastaj shpërndahen nëpër secilën shkollë, kurse në Gjakovë shpërndarja e teksteve bëhet drejtpërdrejt nga kompanitë në shkolla. Të gjitha palët e përfshira thonë se shpërndarja e teksteve shkollore është më efikase kur tekstet dërgohen drejtpërdrejt në shkolla.²⁹ Gjithashtu, bazuar në të dhënat e marra, në fillim të vitit 2015, nga komisioni i inspektimit i MASHT lidhur me rezervat që gjenden në komunat e përzgjedhura është e qartë se Gjakova ka numrin më të ulët të rezervave të teksteve shkollore (rreth 4.000), në krahasim me Pejën (rreth 75.000) dhe Prizrenin (rreth 21.000).

Secila shkollë thotë se e kanë një komision përgjegjës për pranimin e teksteve nga kompanitë botuese dhe shpërndarjen e teksteve tek secili mësimdhënës. Vetëm shkolla fillore "Izvor" ka ofruar dëshmi të shkruar të komisionit të emëruar dhe ngarkuar me një përgjegjësi të tillë, i cili e ka përfunduar detyrën e caktuar. Shkollat tjera kanë konfirmuar emërimin e një komisioni të tillë, por ne nuk na është ofruar asnjë dëshmi për këtë.

3.4 Stoqet e identifikuara në komuna

Gjatë këtij auditimi, ne kemi identifikuar se stoqet e teksteve shkollore janë krijuar në dy mënyra. Në këtë drejtim, stoqet janë tekste të reja që kanë mbetur në depo ose për shkak se numri i teksteve të shpërndara nga kompanitë ka qenë më i lartë se ai i kërkuar nga komunat ose sepse shkollat nuk kanë integruar stoqet në kërkesat e tyre. Një numër shumë i madh i stoqeve janë krijuar gjithashtu nga fakti se tekstet shkollore të kthyer nga nxënësit nuk u janë kaluar brezave të ardhshëm, por kanë mbetur në shkolla.

Kjo çështje është paraqitur në raportin e auditimit të rregullsisë të ZAP për vitin fiskal 2014, ku është gjetur një numër i madh i stoqeve në disa komuna. Përmes këtij raporti, ZAP ka këshilluar MASHT që të marrë një iniciativë për të verifikuar numrin e saktë të këtyre stoqeve dhe vlerës së tyre.

Përmes kësaj iniciative, MASHT ka vërtetuar përmes komisionit të tij se vlera monetare e teksteve që mbeten në shkolla dhe që janë të përdorshme është rreth 503,974 euro.³⁰

²⁸ Intervistë me inspektorët rajonale nga tri komunat dhe zyrtarin e MASHT-it i emëruar si pjesë e komisionit, tetor-nëntor 2015

²⁹ Intervistat me nëntë drejtorët e shkollave të përzgjedhura për këtë auditim, tetor-nëntor 2015.

³⁰ ZAP (qershor, 2015) *Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të MASHT-it për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014*, Kapitulli 4.4, fq. 21

3.5 Kthimi dhe ripërdorimi i teksteve shkollore

Tekstet shkollore ndahen në dy kategori, ato që nuk duhet plotësuar nga nxënësit dhe që duhet të kthehen dhe të tjerat që plotësohen dhe që nuk mund të kthehen.

Norma dhe mënyra e kthimit

Në fund të vitit shkollor mësimdhënësit duhet të sigurojnë se tekstet janë kthyer në gjendje të mirë dhe në të njëjtin numër sikurse që janë pranuar në fillim të vitit, përveç atyre që janë për t'u plotësuar. Bazuar në intervistat tona në shkolla, as drejtorët e shkollave as mësimdhënësit apo nxënësit nuk janë të informuar lidhur me përgjegjësitë që kanë për kthimin e teksteve. Në nëntë shkollat e audituara nuk është ndërmarrë asnjë masë në rastet kur nxënësi ka dëmtuar tekstet ose nuk i ka kthyer.

Shkollat e kanë të vështirë të kontrollojnë kthimin në përfundimin e vitit shkollor, duke pasur parasysh që në pesë nga nëntë shkolla nuk është përdorur asnjë formular për ta dokumentuar shpërndarjen e teksteve shkollore tek nxënësit në fillim të vitit shkollor. Në rastin e shkollës fillore "Selman Riza" dhe "Vaso Pashë Shkodrani", ato kanë përdorur një formular, duke mos siguruar një kthim efektiv të teksteve shkollore. Në anën tjetër, shkollat fillore "Dëshmorët e Kombit" dhe "Izvor" kanë përdorur formularët e tyre dhe kanë siguruar një kthim të lartë të teksteve shkollore. Shkollat fillore të mbetura nuk kanë përdorur asnjë formë ose ndërmarrë ndonjë masë për të siguruar kthimin e teksteve. Një rast ndryshe është vërejtur në shkollën fillore "Hil Mosi" ku nuk është përdorur asnjë formular por norma e kthimit të teksteve shkollore është e lartë.

Bazuar në intervistat e kryera në tri komunat e audituara, ne kemi gjetur se tekstet shkollore nga klasa e parë e deri tek e pesta nuk janë kthyer nga shumica e shkollave. Zyrtarët e DKA e kanë shpjeguar se kjo praktikë është zbatuar kështu për shkak të komunikimit verbal (të pa mbështetur me ndonjë dëshmi të shkruar) që MASHT ka bërë tek përfaqësuesit e DKA. Kjo çështje është konfirmuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MASHT. Bazuar në analizën tonë, nga nxënësit mund të ripërdoren mesatarisht katër tekste shkollore nga klasa e parë tek e pesta, duke marrë parasysh që ato plotësohen me laps.

Praktikat e ripërdorimit

Për të siguruar se tekstet e kthyer vlerësohen dhe ripërdoren, çdo shkollë duhet të organizojë një proces të brendshëm të vlerësimit të këtyre teksteve dhe kjo është e rregulluar me AU.

Një qasje më e mirë e vlerësimit është përdorur nga "Hil Mosi", "Dëshmorët e Kombit" dhe "Izvor". Këto shkolla kanë bërë një organizim të brendshëm, qoftë me përfshirjen e mësimdhënësve ose sekretarëve të shkollave, për të vlerësuar gjendjen e teksteve të kthyer. Në gjashtë shkollat e tjera të audituara, ne kemi vërejtur se një numër i madh i teksteve nuk ripërdoren edhe kur ato kthehen. Një tjetër aspekt që kemi vërejtur nga intervistat e kryera janë ankesat e bëra nga shkollat për cilësinë fizike të teksteve. Por, këto ankesa nuk janë dërguar në MASHT.

Ripërdorimi i teksteve shkollore mbetet një faktor i rëndësishëm për sa i përket kursimeve buxhetore. Në këtë aspekt, ne kemi llogaritur kursimet e mundshme nga tre komunat, duke supozuar se kërkesat për tekstet shkollore nga klasa e parë tek e pesta mund të përdoren, pas kthimit të tyre. Është e rëndësishme të theksohet se “Hil Mosi”, “Dëshmorët e Kombit” dhe “Izvor” kanë ripërdorur ato tekste shkollore nga klasa e parë tek e pesta të cilat nuk kanë qenë të plotësuara nga nxënësit.

Tabela e mëposhtme paraqet kursimet e mundshme, kur vetëm katër tekste për nxënës do të përdoren për një minimum prej dy vjetësh. Kjo llogaritje është për nxënësit nga klasa e parë tek e pesta dhe mbulon vetëm tri komunat e audituara.

Tabela 2. Kursimet e mundshme të buxhetit nga ripërdorimi i teksteve nga klasa e parë tek e pesta

Komunat					
Gjakovë					
Viti shkollor	Nr. i nxënësve	Tekstet që do kthehen	Çmimi mesatar për tekst (€)	Çmimi total për 4 tekste për nxënës (€)	Kursimet (000€)
2013/2014	7,568	4	1.60	6.40	48
2014/2015	7,439	4	1.60	6.40	48
2015/2016	7,089	4	1.60	6.40	45
Prizren					
Viti shkollor	Nr. i nxënësve	Tekstet që do kthehen	Çmimi mesatar për tekst (€)	Çmimi total për 4 tekste për nxënës (€)	Kursimet (000€)
2013/2014	13,340	4	1.60	6.40	85
2014/2015	13,021	4	1.60	6.40	83
2015/2016	13,181	4	1.60	6.40	84
Pejë					
Viti shkollor	Nr. i nxënësve	Tekstet që do kthehen	Çmimi mesatar për tekst (€)	Çmimi total për 4 tekste për nxënës (€)	Kursimet (000€)
2013/2014	7,450	4	1.60	6.40	48
2014/2015	7,451	4	1.60	6.40	48
2015/2016	7,448	4	1.60	6.40	48
Totali i kursimeve për tre vite në tre komunat					€ 538

3.6 Riciklimi i teksteve shkollore

Sipas vëzhgimeve tona në teren kemi kuptuar që çështja e riciklimit të teksteve shkollore është aktivitet që kërkon disiplinë, strukturë, organizim dhe procedura të qarta për të kryer atë.

Çështja e riciklimit të teksteve shkollore është trajtuar nga disa prej shkollave që ne kemi audituar. Riciklimi i teksteve zakonisht kryhet me tekstet e vjetra shkollore që kanë mbetur në magazinat e shkollës për një kohë të gjatë.

Shkolla fillore "Selman Riza" dhe "Vaso Pashë Shkodrani" kanë marrë një iniciativë që të dërgojnë tekstet e papërdorshme për riciklim. Megjithatë, riciklimi nuk është bazuar në ndonjë kriter, pasi që arsyeja e vetme ishte që të eliminohen këto tekste nga shkolla. Si rezultat, ata iu kanë dhënë kompanive tekste shkollore dhe për këtë kanë pranuar kompensim simbolik.

Tabela e mëposhtme paraqet përfitimet e mundshme financiare nëse tekstet do të ricikloheshin si duhet.

Tabela 3. Riciklimi i teksteve të papërdorura

Viti shkollor	Numri i nxënësve në arsimin fillor (000)	Çmimi i riciklimit/kg 0.06€ X 2 kg/nxënës	Kursimet mesatare për vit (000 €)
2013/14	279	0.12	33
2014/15	276	0.12	33
2015/16	261	0.12	31

4 Konkluzione

Ky kapitulli paraqet konkluzioneve të bazuara në të gjeturat e auditimit, të cilat rrjedhin nga praktikat e mira që janë përdorur për të njëjtat qëllime nga entitetet e audituara dhe observimet gjatë punës në terren.

Mangësitë në kornizën ligjore

Terminologjia e kundërt dhe mungesa e formularëve për implementim mbesin si dy mangësitë kyçe të UA, me të cilin organizohet pajisja, shpërndarja dhe kthimi i teksteve shkollore.

Terminologjia e përdorur në tekstet shkollore jepen falas dhe ndërkohë që ata duhet të kthehen krijon konfuzion nëse ato duhet të mbahen nga nxënësit ose të kthehet në shkollë në mënyrë që të ripërdoren. Mungesa e formave në UA e bën të vështirë për aktorët e përfshirë për të menaxhuar si duhet shpërndarjen dhe kthimin e teksteve. Si rezultat, çdo shkollë bënë edhe menaxhimin e procesit në mënyrë individuale.

Përveç kësaj, duke pasur parasysh se ka një mungesë ndërgjegjësimit për ekzistencën e UA që tregon se përpjekjet e zyrtarëve të DKA në dhënien e këtij informacioni mungojnë.

Planifikim i dobët i pajisjes me tekste shkollore

Hapi i parë në proces dhe që po shkakton vështirësi në fazat e tjera, është planifikimi për të pajisur nxënësit me tekste shkollore. MASHT fillon planifikimin e pajisjes me tekste me vonesë dhe kjo ka ndikuar në shkurtimin e kohës së analizimit dhe krahasimit të kërkesave me numrin e nxënësve nga secila komunë. Kjo për shkak të emërimit me vonesë të komisioneve.

Nuk ka koordinim të ndërsjellë në komunikim mes MASHT dhe DKA. Kjo për shkak se në njërin anë shkollat përpilojnë më kohë kërkesat për tekste shkollore dhe i dërgojnë në DKA kurse në anën tjetër MASHT i kërkon këto kërkesa nga DKA në një fazë të vonshme.

Stoqet e teksteve shkollore janë një element tjetër i pashmangshëm për tu marrë parasysh në fazën e planifikimit.

Mangësi në organizimin e shpërndarjes së teksteve shkollore

Shpërndarja e teksteve shkollore nuk është duke u kryer si duhet. Emërimi i vonshëm i komisionit për shpërndarje krijon vështirësi të ndryshme për shpërndarjen e teksteve shkollore pasi që ato dërgohen tek një numër i madh shkollash dhe brenda një kohe shumë të kufizuar. Gjithashtu, komisionet e secilës shkollë që është dashur të pranojnë dhe shpërndajnë tekstet nuk janë emëruar dhe nuk ka dëshmi se si është organizuar ky proces dhe nuk ka shpjegim të përgjegjësive të komisionit. Ndërkohë, komisionet e përcaktuara nga MASHT nuk kanë monitoruar shpërndarjen në një numër të vogël të shkollave dhe si rrjedhim nuk kanë pasqyrë të saktë të situatës.

Kthimi dhe ripërdorimi jo efikas

Norma e kthimit të teksteve në nivel vendi ende mbetet e ulët. Kjo është për shkak të mungesës së përpjekjeve dhe të analizave nga MASHT, DKA dhe shkollat.

Pavarësisht nga fakti se çdo vit është kërkuar që të reduktohen kërkesat për tekste shkollore dhe që të merret parasysh ripërdori i teksteve të kthyera dhe atyre në stok, ne kemi vërejtur se kërkesa për tekste të reja vazhdon të jetë e lartë. Nëse kjo praktikë do të vazhdojë në këtë mënyrë, ajo jo vetëm që mund të shkaktojë ndikime buxhetore, por mund të shërbejë edhe si një shembull për t'u ndjekur nga shkollat e tjera që po bëjnë maksimumin e tyre për të ruajtur dhe kthyer tekstet.

Riciklimi në fazë të hershme të zhvillimit

Riciklimi ka qenë praktikë e aplikuar nga disa shkolla në mënyrë ad hoc. Edhe pse kjo është konsideruar si një mënyrë shumë e mirë për të larguar tekstet e vjetra që kanë mbetur në depot e shkollës, ajo ka treguar se zbatimi nuk është bërë si duhet, duke pasur parasysh se nuk është bërë asnjë analizë për të marrë një vlerë të duhur në këmbim të teksteve të ricikluara.

5 Rekomandime

Për të siguruar përdorim efikas të teksteve shkollore, më poshtë paraqesim rekomandimet për akterët përgjegjës me qëllim të zvogëlimit të shpenzimeve dhe përmirësimin e planifikimit, shpërndarjes, kthimit dhe ripërdorimit të teksteve.

Ne rekomandojmë MASHT të:

- Rishikojë terminologjinë në UA, posaçërisht në modifikimin e termit “falas” me “huazim” për të shmangur konfuzionin;
- Integrojë riciklimin e teksteve brenda UA;
- Krijojë formularë për një menaxhim më të mirë të pajisjes, shpërndarjes, kthimit dhe riciklimit të teksteve dhe të sigurojë që ato janë duke u zbatuar plotësisht nga shkollat;
- Përmirësojë komunikimin me drejtorët e DKA në mënyrë që ata t’ia transmetojnë informacionin lidhur me UA drejtorëve të shkollave dhe mësimitdhënësve;
- Themelojë komisionet për pajisje dhe shpërndarje në periudhën e duhur në mënyrë që të lejohet kohë të mjaftueshme për të analizuar të dhënat e siguruara nga shkollat.

Ne rekomandojmë DKA të:

- Sigurojnë se shkollat kanë integruar në kërkesat e tyre tekstet e kthyera dhe se asnjë kërkesë nuk do të procedohet në MASHT para se kjo të kryhet nga shkolla;
- Sigurojë që të mos ketë stoqe as në depot e komunave dhe as nëpër shkolla.

Ne rekomandojmë drejtorët e shkollave të:

- Krijojnë komisionet për pranimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore;
- Përfshijnë mësimitdhënësit në shpërndarjen e teksteve shkollore dhe të sigurojnë krijimin e një liste lidhur me nevojat për klasë dhe për çdo lëndë. Kjo listë me të gjitha të dhënat duhet të dorëzohet në DKA jo më vonë se në fund të vitit shkollor;
- Komunikojnë në mënyrë aktive me mësimitdhënësit për të siguruar që nxënësit t’i kthejnë tekstet shkollore dhe të kujdesen për to në mënyrë që ato të ripërdoren.

Shtojca 1. Kontrata me prindërit, shkolla fillore "Vaso Pashë Shkodrani"³¹

KLASA III-3

DEKLARATË

Deklaroj, se, unë i më poshtë nënshkruari - prindi i fëmijut tim, me dëshirë, vullnet dhe ndërprerje njëzore, mualllsh dhe materialisht do të përgjigjem për çdo thyerje, prishje, demolim dhe shkatërrim të bankave, karrigave, dritareve, xhamave dhe syjës sanitare, si dhe inventarit tjetër që gjendet në dhomën e mësimit dhe jashtë saj, po që se fëmiju im, gjatë kohës sa qëndron në shkollë, bën thyerje, prishjen, demolin dhe shkatërrimin e mjeteve mësimore që u përmendën më lartë.



Pashtu marr përsipër si prind të kontaktoj, ndihmoj dhe të këshillohem në çdo kohë me arsimtarin e lëndës - kujdestarin e klasës, në mënyrë që të ndikohet dhe psikikisht të përgatitet fëmiju im në këtë dhe aspekte të tjera edukativo - arsimore. Për momentin ky do të jetë një si kontribut imi në ngritjen e pashmangshme të vetëdijes dhe të moralit të fëmijut tonë gjatë zhvillimit të procesit arsimorë - edukativë pranë shkollës fillore "Vaso Pashë Shkodrani" në Pejë.

Deklarata ime njëherit do të konsiderohet si pjesë e dokumentacionit të shkollës.

Nr. rend.	Emri dhe mblemri i prindit	Nënshkrimi	Data
1.	[Redacted]	[Signature]	24.09.2010
2.	[Redacted]	[Signature]	24.09.2010
3.	[Redacted]	[Signature]	24.09.2010.
4.	[Redacted]	[Signature]	24.09.2010
5.	[Redacted]	[Signature]	24.09.2010
6.	[Redacted]	[Signature]	24.09.2010
7.	[Redacted]	[Signature]	24.09.2010
8.	[Redacted]	[Signature]	24.09.2010
3.	[Redacted]	[Signature]	24.09.2010
1.	[Redacted]	[Signature]	24.09.2010

³¹ Nuk na është ofruar ndonjë formë tjetër për mbulimin e viteve të audituara.

Shtojca 2. Marrëveshja me prindërit, shkolla fillore “Izvor”

	
Republika e Kosovës	Komuna e Prizrenit
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti	Opština Prizren – Prizren Belediyesi


DATE/A:	01.09.2013g.
REFERENC-Ë	04/2013 (sp.)
PËR/ZA/TO:	Roditelje,
PËRMESE:	
NGA/OD/FROM:	ONSS „IZVOR“- GORNJE LJUBINJE- PRIZREN
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	SPORAZUM

SPORAZUM

Između ONSS “IZVOR”- koju zastupa razredni stresina VI razreda [REDACTED]

Roditelja ucenika VI razreda (upisati ucenike po rednom broju u dnevniku)

1. Da cemo se svi zalagati za ocuvanje i odrzavanje skolskog inventara, skolskog objekta i udzbenika.
2. Da prihvatamo odredbe ovog sporazuma:
 - Za svako polomljeno staklo na prozoru nadohnadiceмо iznos od:20 Eura
 - Za svaku polomljnu stolicu nadohnadiceмо iznos od 20 Eura
 - Za svaku polomljnu klupu nadohnadiceмо iznos od 35 Eura
 - Za svako ostecenje u toaletu nadohnadiceмо iznos od 20 Eura
 - Za svaki osteceni udzbenik nadohnadiceмо iznos od 10 Eura.
 - Za svako drugo ostecenje skolske imovine ili opreme nadohnadiceмо iznos koji podrazumeva cenu novog plus kaznu za dvostruki iznos za namerno nacinjenu stetiu.



Shtojca 3. Shpërndarja e teksteve për nxënësit e shkollës fillore
"Selman Riza"³²

Nr. seri	Emri dhe mbiesuri	Cjelle shqipe	Cjelle anglize	Matematikë	Shkencë natyrore	Histori	ED. meshkore	ED. femë	ED. Gjuhë	ED. Gjuhë	ED. Gjuhë	ED. Gjuhë	Vërejtje	
1	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ Kancellet
2	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
3	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
4	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
5	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
6	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
7	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
8	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
9	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
10	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
11	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
12	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
13	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
14	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
15	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
16	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
17	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
18	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
19	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
20	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
21	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
22	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
23	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
24	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
25	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
26	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
27	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ -H-
28	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ Kancellet
29	[Redacted]	+2	2	2	2	2	1	1	2	-	2	2	1	+ Kancellet
30	[Redacted]													
31														
32														
33														
34														

Ojakovë, Shtator-2013

³² E njëjta formë e shpërndarjes është përdorur edhe gjatë viteve 2014/15 dhe 2015/16